

Komunikatë për media

Menaxhmenti financiar i ri për tri universitetet publike në Republikën e Kosovës

(Vienë/Prishtinë, XX. Dhjetor 2016. Sistemi i arsimit të lartë publik në Republikën e Kosovës përballet me sfida të mëdha. Një pjesë shumë e rëndësishme është sigurimi i përdorimit sa më efektiv i fondeve publike. Në këtë kontekst, projekti i financuar nga Bashkimi Europian, Tempus " Rritja e autonomisë dhe përgjegjësisë financiare në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë" ka dhënë një shtytje të rëndësishme. Gjatë tre viteve të fundit, fokusi i këtij projekti ka qenë në modernizimin e praktikave të menaxhmentit financiar duke përfshirë edhe trajnimin e plotë të stafit administrativ të universiteteve. Një komponent kryesor i këtij projekti ishte modernizimi teknologjik i infrastrukturës së menaxhimit financiar. Me mbërshtetjen e Bashkimit Europian, hardueri dhe softueri i departamenteve financiare të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka" dhe Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti"u modernizuan në vlerë prej më shumë se 180.000 EUR. "Ky modernizim do të rrisë kapacitetin organizativ në lidhje me menaxhimin financiar të përfituesve të projektit" thotë Horst Rode, i cili është CFO në Universitetin e Shkencave të Aplikuara- FH Campus Wien dhe grant mbajtës i projektit FAITH,

Ngritja e kapaciteteve me modernizimin e manxhimit financiar

Synimi i këtij projekti është mbështetja e modernizimit të administratës financiare e të tre universiteteve. Sistemi aktual nuk ishte në gjendje të përmbushute nevojën e rritjes së transparencës së shpenzimeve dhe shpenzimeve aktuale në krahasim me buxhetin. Prandaj, një softuer i menaxhimit financiar i përshtatur për përmbushjen e nevojat special të institucioneve të arsimit të lartë është krijuar për të lehtësuar proceset e brendshme administrative. Me zbatimin e plotë të softuerit " Menaxhimi i buxhetit dhe financave" në fillim të vitit fiscal 2017, stafi financiar i të tre universiteteve do të jetë në gjendje t'i përdor fondet financiare në mënyrë më efikase. Për më tepër, përdorimi i softuerit të ri do të kontribuoj në më shumë transparencë duke i bashkuar shabllonet gjithashtu dhe procedurat që lidhen me manaxhimin financiar në nivel universitar. Përveç kësaj, funksionaliteti i softuerit të bazuar në ueb gjithashtu thjeshtëson sistemin e raportimit, në këtë mënyrë ua bën të mundur punëtorve të dizajnojnë dhe krijojnë raporte dhe kjo do të çojnë në eliminimin e shpenzimeve të panevojshme. " përmes qasjes së menjëhershme të llojeve të ndryshme të informacioneve financiare ky system gjithëpërfshirës i lejon universitetet dhe ekipeve të tyre të menaxhojnë institucionet e tyre me më shumë efikasitet dhe transparencë në të ardhmen dhe hap rrugën drejt autonomisë së plotë financiare" tha Horst Rode i kënaqur me ndikimin pozitiv të projektit.

Detajet e kontaktit:

Grant mbajtësi

Mag.ªMitraOshidari
Universiteti i Shkencave të Aplikuara- FH CAMPUS WIEN

Komunikimi i Korporatave

Favoritenstraße 226, 1100 Wien

T: +43 1 606 68 77-6409

mitra.oshidari@fh-campuswien.ac.at

www.fh-campuswien.ac.at

Kordinator Regional

Mjellma Carabregu
WUS Kosova

mjellma.carabregu@wuskosova.org

<http://www.wuskosova.org/>



Co-funded by the
Tempus Programme
of the European Union